



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:256556
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05640929

PA1.nr.1084/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.L nga fshati, Komuna e Suharekës, dhe H.K nga fshati, Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, Kanosje nga neni 181 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkritazi me ankesën e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1262/2022 të dt.07.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1262/2022 të dt.07.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.1262/2022 të dt.07.07.2023, të akuzuarin B.L dhe H.K e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Dhuna në familje nga neni 248 par. 3 nën par. 3.2 të KPRK-së, dhe të akuzuarit B.L i ka shqiptuar dënim e dënim me gjobë në shumën prej 250,00/dyqindpesëdhjetë/ Eurove, të cilën shumë të dënimit është i obliguar që të paguajë në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast të mos pagesës së dënimit më gjobë as me detyrim, i njëjti dënim me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 12 ditë burgim si dhe të akuzuari H.K i ka

shqiptuar dënim me gjobë në shumen prej 250,00/dyqindpesëdhjetë/ Eurove, të cilën shumë të dënimit është i obliguar që të paguaj në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast të mos pagesës së dënimit me gjobë as me detyrim, i njëjti dënim me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 12 ditë burgim. Te akuzuarit obligohen që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërkaq në emër të paushallit gjyqësor shumën secili veç e veç me nga 30 Euro, në emër të kompensimit për viktimat e krimit, shumen secili veç e veç me nga 20,00 euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, I dëmtuari A.K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, për shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par. 1, nën.par.1.3 në lidhmë me nenin 369 par.7 të KPPRK-së dhe vendimit mbi sanksionin penal, nga neni 387 par. 1 të KPPRK-së, me propozim që gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarve ti shqiptoj dënim me burgim efektiv, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimi ose ta anuloj dhe lëndën penale të kthejë në rigjykim dhe rivendim.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1120/2023 të datës 06.09.2023, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim meritator sipas ligjit me tmeritor sipas ligjit me të cilin do të arrihet në mënyrë të plotë qëllimi i dënimit. Ndërsa përgjigjja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Të akuzuarit B.L dhe H.K kanë paraqitur përgjigje të përbashkët në ankesë me të cilën kanë propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet në tersi si i ligjshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1, nën.par.1.3 në lidhmë me nenin 369 par.7 të KPPRK-së dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, nga neni 387 par. 1 të KPPRK-së, me pretendimet aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së gjykata së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje këto të parapara me nenin 384 par. 1, nën.par.1 e lidhur me dispozitën e nenit 240 par.2 të KPPRK-së, ngase shqyrtimit fillestar është mbajtur pa persona prania e të cilave në shqyrtim gjyqësorë, gjegjësisht në rastin konkret në shqyrtimin fillestar është mbajtur pa persona, prania e të cilave në shqyrtim gjyqësorë kërkohet me ligj, gjegjësisht në rastin

konkret në shqyrtimin fillestar e që kjo vërtetohet edhe nga procesverbali i shqyrtimit fillestar 07.07.2023, në të cilën shqyrtim prezent kanë qenë prokurori i shtetit dhe të pandehurit B.Ldhe H.K, ndërsa nuk ka qenë prezent i dëmtuari A.K dhe gjykata në procesverbal nuk ka konstatuar fare nëse i dëmtuari ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt apo nuk ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt, nga të cilat fakte do të vërtetohet nëse pala e dëmtuar është ftuar në mënyrë të rregullt apo në mënyrë të parregullt, për mbajtjen e shqyrtimit fillestar. Gjithashtu aktgjykimi i gjykatës shkallës së parë, pjesa ndëshkuese e saj është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyet e paraqitura në arsyetim. Dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, i pakuptueshëm me arsyetimin lidhur me faktet vendimtare, ku në dispozitiv saktësisht përshkruan veprimet inkriminuese për veprën penale Kanosja, nga neni 181 par. I lidhur me nenin 31 i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK), ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk jep asnjë fakt vendimtar lidhur me shqiptimin e dënimeve për të pandehurve për secilin veç e veç dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro, ku në rastin konkret gjykata përveç rrethanave lehtësuese, nuk ka gjetur rrethana rënduese e të cilat kanë ekzistuar siç janë shkalla e lartë e dashjes për kryerjen e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur në rastin konkret, frikën dhe shqetësimin emocional të shkaktuar të dëmtuarit dhe shkallën e përgjegjësisë penale, andaj nga këto rrethana prokurori i shtetit konsideron se aktgjykimi është përfshirë në Shkelje esenciale nga neni 384 par. 1, nën.par. 1.3 në lidhmë me nenin 369 par.7 të KPRK-së. Tutje vazhdon sa i përket lartësisë së dënimit gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit të lartësitë së dënimit, përveç rrethanave lehtësuese, nuk ka gjetur rrethana rënduese e të cilat kanë ekzistuar siç janë shkalla e lartë e dashjes për kryerjen e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur në rastin konkret, frikën dhe shqetësimin emocional të shkaktuar të dëmtuarit dhe shkallën e përgjegjësisë penale. Prandaj konsiderojmë se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës, nuk i përgjigjet peshës së veprës penale dhe rrethanat nën të cilat është kryer dhe dënimi i këtillë të shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KP, sipas të cilit qëllimi i sanksionit penal është:

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i shqyrtoi pretendimet ankimore të lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjithashtu në mbështetje të nenit 394, paragrafi 1. të KPRK-së, edhe sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar në këtë drejtim dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara me ankesë, si dhe as shkelje tjera të procedurës, të cilat kjo gjykatë i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur në të cilën janë paraqitur rrethana rënduese të cilat gjykata e shkallës së parë nuk i ka marr për bazë nuk paraqesin rrethanë të rëndësishme dhe të posaçme të cilat do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të lart për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit në pajtim me dispozitat e nenit 69 të KPK-së, pati

parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se të akuzuarit kanë pranuar fajësisë, sjellja korrekte pas kryerjes se veprës penale, pendimi i thelle i tyre, e në kuptim të nenit 70, 71 e 72 gjykata morri parasysh se të akuzuarit kanë bashkëpunuar me gjykatën, bashkëpunimi i tyre ka qenë vullnetar në hetimin dhe ndjekjen penale, kanë pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, pa ndikim e as presion nga jashtë, si edhe kanë shprehur keqardhje për shkak të veprës penale, kanë pasur sjellje korrekte para gjykatës dhe publikisht i kërkojnë falje të dëmtuarit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e prokurorit për ti shqiptuar një dënim më të lart konsideron se janë të pabazuara, ngase të gjitha rrethanat, e sidomos duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarave, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1084/2023, më datë 24.04.2024

Procesmbajtësja,
Ilmije Rexhepi Beqiri

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Ferit Osmani

Abdullah Ahmeti
